



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 324/ Prot.
2

Tiranë, më 2.05.2017

VENDIM

Nr. 67, datë 2/5/2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") ankesat nr. 51 Prot., datë 11.01.2017, nr. 77 Prot., datë 16.01.2017 dhe nr. 166, 167, 168 Prot. datë 27.01.2017 me objekt, "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare" ndaj Autoritetit Publik "Bashkia Kurbin" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").
Me datë 18.12.2016 Z. ka përcjellë pranë Autoritetit Publik me anë të postës elektronike kërkesën për informacion, si më poshtë:

Në lidhje me ankesën nr.51 prot:

1. Sa është numri i përgjithshëm i ish të përndjekurve politikë me banim në territorin e Bashkisë Kurbin, për periudhën 8.11.1941 deri më datën 22.3.1992 ? (Sipas ligjit Për Statusin e Ish - të Përndjekurve Politikë nga Sistemi Komunist);
1.1 Sa është numri i përgjithshëm i ish të përndjekurve politikë me banim në territorin e Njësisë Administrative Fushë Kuqe, Bashkia Kurbin, për periudhën 8.11.1941 deri më datën 22.3.1992 ? (Sipas ligjit për Statusin e Ish - të Përndjekurve Politikë nga Sistemi Komunist)

Sa është numri për secilën nga kategoritë e mëposhtme:

- a) Persona që kanë humbur jetën ose janë të sëmurë psikik për shkak të përndjekjes;
- b) Persona që janë dënuar me heqje lirie ose kanë qëndruar në arrati brenda vendit për shkak të përndjekjes;
- c) Persona që janë dënuar me internim, dëbim për shkak të përndjekjes; persona shqiptarë që kanë pasur shtetësi të huaj, sot shtetas shqiptar, e që kanë jetuar në kampe përqendrimi të ngritura posaçërisht për ta;

- d) *Persona që kanë humbur të drejtat qytetare, kulakët e fshatit, të deklasuarit dhe ata që kanë pësuar privime të llojeve të ndryshme për shkak të përndjekjes;*
 - e) *Persona, të cilët megjithëse plotësojnë kushtet për t'u kategorizuar në një nga kategoritë e mësipërme, nuk përfitojnë të drejtën e këtij statusi;*
 - f) *Sa është numri i ish të përndjekurve, që gjatë kësaj periudhe që rezultojnë akoma të zhdukur nga regjimi, dhe akoma nuk ju është gjetur varri?*
2. *Sa është numri i të punësuarve të kësaj shtrese, ish të përndjekurve politikë / trashëgimtarëve të tyre ligjorë, në Institucionin e Bashkisë Kurbin? Cilat role përfaqësojnë ata në Bashkinë Kurbin?*
 3. *A ka Bashkia Kurbin një listë emërore (Emër Mbiemër, Datëlindje vendlindje / vendbanim) për të gjithë ish përndjekurit politikë që banojnë në territorin e Bashkisë Kurbin? Nëse po, a është i mundshëm ky informacion për publikun e gjerë?*
 4. *Nëse nuk e ka një Listë emërore me një informacion të tillë, përse jo? Cilat janë masat që Bashkia Kurbin ka ndërmarrë në kuadër të vendimit të sipërcituar të KLSH-së, për rehabilitimin e plotë të kësaj shtrese?*
 5. *Sa është numri i shoqatave të ish përndjekurve politikë që veprojnë në territorin e Bashkisë Kurbin, kërkoj një kopje me emrat dhe kontaktet e drejtuesve të këtyre shoqatave, email telefon, adresë, faqe internet?*

Me datë 28.12.2016 Z. _____ ka përcjellë pranë Autoritetit Publik me anë të postës elektronike kërkesën për informacion, si më poshtë:

Në lidhje me ankesën nr.77 prot:

1. *Një kopje të kërkesës së dorëheqjes / largimit nga detyra të ish administratorit të Nj.A. Fushë Kuqe pas marrjes së vendimit për t'u larguar nga kjo detyrë. Një kopje të vendimit të Bashkisë për pranimin e kërkesës / largimin e ish Administratorit të Nj.A. Fushë Kuqe,*
2. *Një kopje të gjitha procedurave ligjore administrative të ndjekura nga Bashkia Kurbin për zëvendësimin e Tij.*
3. *Një kopje të lajmërimit / reklamimit për vendin e lirë të punës së Administrator të Nj.A. Fushë Kuqe. Një kopje të vlerësimit të kandidataturave nga juria / paneli përkatës i rekrutimit të këtij roli.*
4. *Një kopje të CV-së së administratorit të përzgjedhur për Njësinë Administrative të Fushë Kuqe, Bashkia Kurbin.*
5. *Një kopje të plote të personelit të Administratës së Njësisë Administrative të Fushë Kuqe, Bashkia Kurbin duke përfshirë: Emrin, mbiemrin, funksionin dhe numrin e telefonit për komunikim me publikun.*

Me datë 06.01.2017 Z. _____ ka përcjellë pranë Autoritetit Publik me anë të postës elektronike kërkesën për informacion, si më poshtë:

Në lidhje me ankesën -nr.166 prot:

1. *CV-të e të gjithë personave të përzgjedhur, për të gjitha funksionet/rolet e shpallura në faqen e internetit (Përgjegjës dhe Drejtorë). gjatë muajit Tetor 2016;*
2. *Procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre;*
3. *Një kopje të përditësuar të të gjithë organikës me personelin e Bashkisë Kurbin duke përfshirë: emrat, mbiemrat, funksionin/rolin, adresën e emailit dhe numrat e telefonit për përdorim zyrtar.*

Në lidhje me ankesën nr.167 prot:

1. *Cilat janë masat specifike që Nj.A. Fushë-Kuqe – Bashkia Kurbin ka ndërmarrë, që të hapen puse për familjet e kësaj zone, për të mos pasur probleme me furnizimin me ujë të pijshëm? Sa është numri i familjeve që kanë përfituar nga masat e marra nga ana juaj? Si janë përzgjedhur ato, mbi çfarë kriteresh?*
2. *Cilat janë masat specifike që Nj.A. Fushë-Kuqe – Bashkia Kurbin ka ndërmarrë, që të hapen puse për institucionet që ushtrojnë aktivitetin e kësaj zone, për të mos pasur probleme me furnizimin me ujë të pijshëm? Sa është numri i institucioneve që kanë përfituar nga masat e marra nga ana juaj? Një listë të institucioneve përfituese nga masat e marra nga ana juaj?*
 - *Cila kompani ka bërë shpimet për “hapjen e puseve” të cilës i referohet Administratori?*
 - *A është e licencuar nga Bashkia Kurbin për ushtrimin e këtij aktiviteti?*
 - *Cilat janë detyrimet tatimore të kompanisë që ka ushtruar këtë aktivitet ndaj Bashkisë Kurbin?*
 - *Sa është tarifa e kësaj “kompanie” për “hapjen e një pusi” për banorët e Nj.A. Fushë Kuqe?*
 - *A janë të pajisura me leje mjedisore për ushtrimin e këtij aktiviteti?*
 - *Nëse po, një kopje të lejes mjedisore për ushtrimin e këtij aktiviteti?*
 - *Nëse jo, a është bërë hapja e puseve në përputhje me kërkesat dhe detyrimet ligjore?*
 - *A i përmbushin standardet ligjore të higjienës dhe shëndetit këto burime për përdorimin e ujit të pijshëm?*
 - *Nëse po, cili institucion i ka kontrolluar dhe certifikuar si të tilla? Nëse jo, mbi çfarë baze ligjore ka vepruar Nj.A. Fushë Kuqe – Bashkia Kurbin për lejimin e shfrytëzimit të këtyre puseve për përdorim uji të pijshëm?*

Në lidhje me ankesën nr. 168 prot:

1. *Sa është shuma e shpenzuar nga Bashkia Kurbin për hapjen e faqes së internetit dhe popullimin e saj me informacionin e duhur? Nëse është kontraktuar nga jashtë Bashkisë, kërkoj një kopje të faturës së paguar për shërbimet e kësaj faqeje në internet, nga Bashkia Kurbin.*
2. *Një kopje të të gjitha vendimeve të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Kurbin nga konstituimi deri në ditën e dhënies së informacionit. Komisioneri për të Drejtën e Informimit nëpërmjet dy shkresave të mëparshme i ka kërkuar Bashkisë Kurbin vënien në dispozicionin tim të informacionit të kërkuar. Cila është arsyeja e vazhdimit të refuzimit të dhënies së informacionit nga ana juaj?*
3. *Cila është arsyeja që Bashkia Kurbin vazhdon të mos e publikojë “Programin e Transparencës” në faqen zyrtare në internet ndonëse në dy shkresat e mëparshme ky detyrim ligjor ju është rikujtuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit?*
4. *Cila është arsyeja që Bashkia Kurbin vazhdon të mos caktojë Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe të mos ketë të publikuar kontaktet e tij/saj në faqen zyrtare të internetit.*

Ankuesi pretendon se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me Urdhrat nr. 50, 51, 52 datë 16.02.2017 vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e këtyre ankesave.

Gjithashtu, Komisioneri ka monitoruar faqen zyrtare në internet të këtij Autoriteti Publik dhe ka konstatuar se nuk është publikuar informacioni në përputhje me kërkesat ligjore.

Për këtë arsye, me Urdhrin nr. 53 datë 16.02.2017, Komisioneri vendosi fillimin kryesisht të hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik lidhur me:

- Përbushjen e detyrimit për përgatitjen dhe miratimin e programeve të transparencës, referuar nenit 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim quajtur “Ligji për të Drejtën e Informimit”).
- Përbushjen e detyrimit për vënien në dispozicion të publikut në faqen zyrtare në internet, të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë, referuar nenit 7 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit.
- Përbushjen e detyrimit për krijimin, mbajtjen dhe bërjen publike të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar nenit 8 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit.
- Përbushjen e detyrimit për caktimin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, referuar nenit 10 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit.

Grupi i inspektimit konstatoi se Autoriteti Publik nuk ka përbushur detyrimet e përcaktuara në nenet 4 dhe 8 të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Bazuar në nenin 4 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit, çdo Autoritet Publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

Mospërbushja e detyrimit që buron nga ky nen përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 50.000 lekë deri në 100.000 lekë.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit, Autoriteti Publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.

Gjatë inspektimit është konstatuar se kërkesat për informacion janë përcjellë pranë Autoritetit Publik nga Z. me anë të postës elektronike dhe nuk janë regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe të Përgjigjeve.

Në bazë të nenit 11, pikat 1 dhe 2, kërkesat për informim regjistrohen pranë Regjistrit të Kërkesave dhe të Përgjigjeve, duke iu caktuar një numër rendor i cili i jepet kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.

Në bazë të nenit 18, pika 2 d), mospërbushja e detyrimit për krijimin, mbajtjen, publikimin apo përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve brenda afateve të caktuara në ligj përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë e cila varion nga 50.000 deri në 100.000 lekë. Ndërsa mospërbushja e detyrimit të caktuar sipas nenit 11, pika 2 e Ligjit për të Drejtën e Informimit (caktimi i numrit rendor) dënohet me gjobë e cila varion nga 150.000 deri në 300.000 lekë.

Gjithashtu grupi i inspektimit komunikoi me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik i cili sqaroi se nuk ka dijeni për asnjërën prej kërkesave të ankuesit.

Nga inspektimi rezultoi se posta elektronike zyrtare e institucionit administrohej nga sekretarja e Kryetarit të Bashkisë Kurbin.

Kjo e fundit sqaroi se në kohën kur janë dërguar kërkesat për informacion nga Z. ka qenë me leje vjetore (fakt që provohet me shkresën nr. 2285/3 datë 23.12.2016), dhe sapo është kthyer ia ka përcjellë ato Nënkyetarit dhe Drejtorit të Kabinetit të Bashkisë Kurbin. Për më tej deklaroi se nuk kishte informacion.

Në bazë të nenit 10 të Ligjit për të Drejtën e Informimit, me qëllim zbatimin e këtij ligji dhe bashkërendimin e punës për të drejtën e informimit, Autoriteti Publik cakton një prej nëpunësve si Koordinator për të Drejtën e Informimit i cili në përmbushje të këtij funksioni ushtron kompetencat sipas pikës 2 të këtij neni.

Autoriteti Publik ka caktuar një Koordinator për të Drejtën e Informimit, por siç është parashtruar më sipër, është konstatuar se titullari i Autoritetit Publik ka vepruar vetë në mënyrë të vazhdueshme në cilësinë e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, duke mos i lejuar këtij të fundit kryerjen e funksionit që i është caktuar, çka ka sjellë edhe mospërmbushje të detyrimit për dhënie informacioni nga Autoriteti Publik.

Lidhur me ankesën e Z. _____ kundër Autoritetit Publik, grupi i inspektimit, konstatoi se Z. _____ nuk i është kthyer përgjigje.

Në bazë të nenit 15 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit, Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve punë nga data e dorëzimit të saj. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës brenda këtij afati konsiderohet refuzim dhe bazuar në nenin 18, pika 2 a) e Ligjit Për të Drejtën e Informimit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150 000 deri në 300 000 lekë.

Gjatë inspektimit u parashtruan faktet dhe u hartua procesverbali, i cili u nënshkrua pa vërejtje nga ana e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Autoriteti Publik.

Pas shqyrtimit të ankesës, kryerjes së inspektimit dhe vlerësimit të provave të administruara rezulton se, informacioni i kërkuar nga Z. _____ përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit, ku *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Gjithashtu, disa nga kërkesat e Z. _____ bëjnë pjesë në atë kategori informacioni që, bazuar në nenin 7 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit duhet të jenë të publikuara në Programin e Transparencës së Autoritetit Publik si dhe t'i vihen në dispozicion publikut pa kërkesë.

Sa më sipër, konstatohet se jemi përpara disa shkeljeve të dispozitave të Ligjit për të Drejtën e Informimit të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë sipas nenit 18 të tij.

Në zbatim të pikës 1 të nenit 19 të Ligjit për të Drejtën e Informimit, titullari i Autoritetit Publik, pra Kryetari i Bashkisë Kurbin është përgjegjës për mosvënien në zbatim të programit të transparencës në përputhje me nenin 4 të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Gjithashtu, duke ushtruar në mënyrë të vazhdueshme kompetencat që Ligji për të Drejtën e Informimit ia njej Koordinatorit, edhe përgjegjësia administrative për mostrajtimin e kërkesës brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 15, pika 1 e Ligjit, i ngarkohet titullarit.

Sa i përket Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, në momentin e pranimin të këtij funksioni ai duhet të kishte marrë masat për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ky funksion ku përfshihet krijimi, ruajtja, publikimi dhe përditësimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve sipas nenit 10 të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 19 të Ligjit për të Drejtën e Informimit, Koordinatorin ngarkohet me përgjegjësi administrative për mospërmbushjen e ketyre detyrimeve.

Në lidhje me ankimin e Z. _____, kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a), b) dhe d) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 1 dhe 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjën b) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Z. _____, ndaj Autoritetit Publik "Bashkia Kurbin", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik "Bashkia Kurbin" për vënien në dispozicion të ankuesit të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesave për informacion datë 18.12.2016, 28.12.2016 dhe 06.01.2017.
3. Dënimin e titullarit të Autoritetit Publik, Kryetari i Bashkisë Kurbin, Z. _____, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 18 pika 2 b) dhe 19 pika 1. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Bashkisë Kurbin brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Dënimin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit të Autoritetit Publik, Z. _____ me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 18 pika 2 d) dhe 19 pika 3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Bashkisë Kurbin brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
5. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
6. Kundër vendimmarrjes në pikat 3 dhe 4, personat ndaj të cilëve është vendosur sanksioni administrativ kanë të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 22 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
7. Ky vendim u dha sot në datë 2 . 5 .2017.

